



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TE PRONAVE

Rruga "Muhamet Gjollësia", Nr.54, Tiranë, Tel/fax: +355 4 256 831/11

URDHËR

Nr. 377 datë 17.11 .2014

Për

marrjen e masave për zbatimin e ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar, në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave".

Në mbështetje të ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar, të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 13.08.2010 "për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave" të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Të publikohet në faqen e web të AKKP "Kodi Etikës i AKKP" i miratuar me Urdhërin nr.274, datë 15.07.2014 dhe në vend të dukshëm të publikohen mesazhe informuese si dhe pika 8 e nenit 12 të "Kodit Etik" ku te citohet se:
"Në të gjitha ambientet e AKKP-së është rreptësisht e ndaluar pirja e duhanit".
2. Në të gjitha mjediset e punës të AKKP të vendosen shenja të dukshme që tregojnë se pirja e duhanit në këto mjedise është e ndaluar. Format dhe teksti i shenjave paralajmëruese të jenë si ato të përcaktuara nga Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit dhe Produktet e Duhanit(KNMSHPD).
3. Të hiqen dhe të mos përdoren të gjitha tavllat e duhanit në mjediset e punës të AKKP.
4. Në rast të konstatimit të shkeljes së kërkesave të ligjit personi përgjegjës do të dënohet me gjobë sipas përcaktimeve ligjore nga institucionet kompetente.
5. Si person përgjegjës në rastet e shkeljes të ligjit do të jetë duhanpirësi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Sonila Qato

Drejtor i Përgjithshëm

www.akkp.gov.al